

SHTOJCA 1

FORMULARI I KËRKESËS PËR LEJE MJEDISORE

Emri i kompanisë	“PO PETROL – FARIZ, FARIZ MAZREK B.I”
Lloji i veprimtarisë	Depo e Naftës
Emri dhe mbiemri i aplikuesit / Nënshkrimi	Farizk Mazrek
Vendi dhe lokacioni	Komuna e Mamushës, Këshla
Telefoni , fax, e-mail	048900099 fmazrek14@gmail.com
Kopja e Vendimit të Pëlqim Mjedisor	Po
Certifikatë përdorimi, ose Leje/ Licencë për ushtrim të veprimtarisë nga organi kompetent	Po
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro)	Po

Fatura e pagesës se tarifës për Leje Mjedisore	Po
Aplikacionin origjinal të plotësuar për Leje Mjedisore në 5 (pesë) kopje fizike dhe një elektronike (CD).	Po

SHTOJCA 2

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për Operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	"PO PETROL - FARIZ, FARIZ MAZREK B.I"
	Vendi	Mamushë
	Adresa	Këshle, Mamushë
	Nr. i tel./fax	048900099
	E-mail	fmazrek14@gmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810072364 16.11.2017
1.1.3.	Personi kontaktues për mjedis	Fisnik Muji
	Nr. i tel./fax	045616965
	E-mail	fisnikmuji7@gmail.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	"PO PETROL - FARIZ, FARIZ MAZREK B.I"
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Këshle, Mamushë

1.2.3.	Informatat për mjedisin-ndikimet nga kryerja e aktiviteteve	Nga aktiviteti e depos së naftës , ndikimet kryesore në Mjedis kanë qenë: ndikimet në ajër, ujë, tokë, ndikimet nga zhurma. Këto ndikime janë të paraqitura në pikat, 4.2, 5.1, 6.1. dhe 7.1 të Aplikacionit për dhënien e Lejes Mjedisore
--------	---	---

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT


2.1.	Të dhënat për lokacioni ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Depoja e naftës gjendet në Mamushë në zonën kadastrale mamushë dhe ka një sipërfaqe prej 1802m² dhe numri i parcellës është 00746-5 dhe me koordinata 42°20'16.3"V 20°43'54.8"L. Në hartën në vijim shihen lokacionet ku janë të vendosura panelet solare :  Fig 1. Lokacioni i deposë së naftës
------	---	--

		 Fig 2. Pamja e lokacionit me Google Earth
2..2	Numri kadastral i parcelës	Numri i parcelës është P-73213054-00746-5.
2.3	Përshkrimi i lokacionit dhe të gjitha objekteve aktivitetet e tyre në atë zonë.	Në lokacionin ku gjendet depoja e naftës me koordinata 42°20'16.3"V 20°43'54.8"L, toka ka destinim për afarizëm, tregti dhe industri si dhe ka një sipërfaqe prej 1802m ² . Poashtu sipërfaqja e parcellës është relativisht e rrafshët me një pjerrtësi të vogël nga ana perendimore
2.4	Të dhënat lidhur me florën dhe faunën në atë lokacion	Mjedisi natyror në Mamushë është i pasur dhe i larmishëm. Pylli është i mbjellur me drunjë të ndryshëm dhe shkurre që janë vendbanim për kafshë të egra si dhe ekziston edhe një biodiversitet i pasur në zonën përgjatë lumenjve dhe rrugëve në fushat bujqësore. Zona në atë lokacion nuk karakterizohet me prani të madhe të biodiversitetit, megjatë në atë zonë ka prani të zvarranikëve të vegjelë dhe të shpendëve.
2.1.4.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Në lokacioni ku gjendet depoja e naftës, nuk ka ndonjë zonë të veçantë të mbrojtur.


3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore

3.1.1.

Skema e procesit
teknologjik

Fillimisht është bërë hapja e kanalit për betonim të rezervuarëve, pastaj është kthyer dhe është vendosur mbi pllaken e rezervuari dhe për shkak të sigurisë rezervuaret janë vendosur nën dhe. Rezervuarete janë të vendosur në bunker nëntokësor dhe janë të mbrojtur nga ndikimet e jashtme atmosferike, poashtu edhe mbushtorja. Poashtu janë paraqitur edhe: baza e bodrumit të rezervuarit si dhe prerjet tërthore të rezervuari



3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Depoja e naftës ka një numër të rezervuarve prej 13 sosh me nje kapa citet prej 740,158 litra nafte dhe benzine andaj edhe ngarkesa ndaj zjarrit në objekt bëhet përshkak të destinimit të objektit si dhe për shkak të vlerave kalorike të materialeve nga të cilat është ndërtuar objekti. Sa i përket destinimit të objektit e llogarisim me ngarkes të madhe ndaj zjarrit. Ngarkesa e zjarrëve sipas normave teknike IEC (JUS U. J 1.030), stacionet e naftës dhe benzinës i takojnë grupit të zjarreve me ngarkesë të madhe të zjarrit mbi 2GJ/m² (gjatë llogaritjes së grupit të ngarkeses specifike të zjarrit janë marrë parasyshë të gjitha materialet djegëse, të cilat janë pjesë përbërëse e objektit). Pikë mjaftë e rëndësishme është nxemja e objektit që parashihet të bëhet me paisje elektrike me mbrojtje sipas normave të BE- së (EXP) ku në çdo kthinë parashihet ventilim natyror. Poashtu mbrojtja e rezervuarëve nga korozioni do të bëhet sipas konditave që diktohen për vendosje të lëndëve ndezëse. Aparatet për furnizim me lëndë të mjeteve motorike duhet të testohen dhe të lejohen nga organi përgjegjës. Aparatet (pompat) duhen të kenë ventil për mbyllje automatike në të gjitha pozitat e dorëzes për mbushje edhe kur ai është jashtë pune. Gypat në stacion duhet në pikëpamje projektuese, konstruktiv, paisje, shqyrtim dhe shënim të i plotsojnë kushtet e parapara me normat përgjegjëse teknike për ndrëtimin e stabilimenteve me lëndë ndezëse, gjithashtu vendosjen, mbushjen e lëndëve ndezëse të cilat përbëjnë pjesën përbërse të rregullores mbi ndertimin e stabilimenteve të lëndëve ndezëse si dhe vendosjen, mbushjen e lëndëve ndezëse. Gypat vendosën brenda në tokë dhe do të mbrohen ndaj korozionit sipas rregullave. Gjithashtu Furnizimi më energji elektrike i depozitës së gazit bëhet nga rrjeti i shpërndarjes i tensionit të ulët 220 V, rrjet ky nëpërmjet të cilit do të furnizohet objekti i pikës së gazit. Të gjitha pajisjet të cilat furnizohen më energji elektrike janë
--------	--	--

		mirë të tokëzuara, por investitori gjithashtu posedon gjenerator më kapacitet 20 KW. Zonat klasifikohen sipas probabilitetit të shfaqjes së grumbullimit të ndezshëm të fazës së gaztë ose avujve të gazit të lëngëzuar. Në objekt janë të realizuar prizat monofaze dhe trefazor me përques PPOO, me seksion 3 x2.5 mm² dhe 5 x 2.5 mm². Ndriqimi i brendshëm është realizuar me llampa fluoreshente. Ndriqimi i hapësirës rrethë stacionit të benzinës është realizuar me llampa me kapacitet më të lartë. Ndriqimi i hapësirës rrethë stacionit të propan butan-gazit është realizuar me reflektorë. Ndriqimi i brendshëm i objektit për mbushje dhe zbrazje të bombolave është realizuar me llampa me "Ex" mbrojtje
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	8 deri në 10 orë në ditë. 5 deri në 6 ditë pune në javë
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditorë, mujor, vjetor	740,158 litra, naftë dhe benzin
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse.	Vetëm benzina dhe nafta dhe nuk bëhet shfrytëzimi i ndonjë lënde tjetër
3.1.6.	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre	13 rezervuar me kapacitet 740,158 litra
3.1.7.	Lista e legjislacionit dhe udhëzimeve administrative në fuqi	Për plotësimin e formularit për Leje Mjedisore për kompaninë "PO PETROL FARIZ, FARIZ MAZREK B I" është bazuar në ligjet dhe udhëzimet administrative të listuara më poshtë: <u>Ligjet</u>

		➤ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 ➤ Ligji për Mbeturina Nr. 08/L-071 (2022) ➤ Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110 ➤ Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 ➤ Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 02/L-41 ➤ Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233 ➤ Ligji për Mbrojtjen e Ajrit (Nr.08/L-025) ➤ Ligji për VNM Nr. 08/L-181 ➤ Ligji për Trashëgiminë Kulturore (Nr. 02/L-088). ➤ Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174 ➤ Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26 ➤ Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 ➤ Udhëzim Administrativ Nr.04/2022 per Leje Mjedisore ➤ UA Nr. 02/2011 për Normat e Cilësisë së Ajrit; ➤ Udhëzimi administrativ- nr. 13/2013 Për katalogun Shtetëror të mbeturinave.
--	--	---

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania është e angazhuar që në çdo veprim dhe funksion të brendshëm të promovojë përmirësim të vazhdueshëm në mbrojtjen e mjedisit dhe respektimin e kërkesave ligjore. Një indikacion i rëndësishëm që kompania konsideron që duhet zbatuar është edhe zbatimi i sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14001 që do të i mundësonte të: ➤ Identifikonin dhe vlerësonin ndikimet mjedisore që rrjedhin nga aktivitetet e kompanisë; ➤ Vendosin masa konkrete për parandalimin e ndotjes dhe minimizimin e ndikimeve negative; ➤ Sigurojnë përputhshmëri me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat rregullatore; ➤ Forcojnë transparencën dhe bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse dhe palët e interesuara. Përmes këtij angazhimi, kompania synonë të kontribuojë në një mjedis më të pastër, të sigurt dhe të qëndrueshëm.
3.2.2.	Raportimi	Kompania ka bërë raportimet përkatëse në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në përputhje me kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në Lejen Mjedisore. Të gjitha raportimet janë realizuar në afatet dhe formatin e kërkuar, duke respektuar legjislacionin mjedisor në fuqi dhe obligimet që rrjedhin nga ligji.

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.1	Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse	Gjatë fazes së ndërtimit pikat e burimit të emisioneve të ndotëse janë: ➤ Emitim të materieve të ndotura në ajër nga automjetet dhe mekanizmat ndërtimor ➤ Pluhur i cili është ngritur gjatë punëve ndërtimore, pastrimeve, hapjeve të kanaleve, gjurmimit dhe për futjen e tanqeve apo rezervuareve si dhe shtruarja me dhe e platosë dhe rrugësë me asfalt ➤ Lëvizja e automjeteve dhe mekanizmave gjatë punës. ➤ Në fazën e operimit: ➤ Nuk do të ketë emisione të materieve ndotëse nëse gjatë mbushjes së cisternave të kamioneve përdorimi i gypit fleksibil për mbushje përdoret në mënyrë adekuate.
4.2	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit në fazën e operimit: Funksioni i deponisë së derivateve të naftës, gjatë kohës së qarkullimit të kamioneve të cilët do të arrijnë në pikën e mbushjes së cisternave, mund të sjellë ndotjen e ajrit nga lrimi i emisioneve të gazrave serrë dhe të pluhurit. Gazrat që emetohen nga djegiet motorike përmbajnë një shumëllojshmëri komponentësh ndotës me nivele të ndryshme koncentracioneve, mirpo ndër më të rëndësishmit në kontekstin e ndotjes së ajrit janë: ➤ CO₂ ➤ CO ➤ NO_x ➤ SO₂ ➤ Pb ➤ Grimcat PM₁₀ ➤ Grimcat PM_{2.5}

		Ndikimi i këtyre substancave janë jo vetëm shkaktarë të ndotjes atmosferike, por gjithashtu kontribuojnë në formimin e smogut, acidifikimin e resurseve ujore dhe probleme të ndryshme shëndetësore si sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare
4.3	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzeve të emisioneve të materieve ndotëse paraqitën nga pluhurat të cilët lirohen nga qarkullimi i automjetet brenda dhe jashtë hapësirës punuese kjo për arsye të mbushjes apo furnizimit me naftë apo benzin dhe gjatë mbushjes ku kamionet mund të mos i përmbahen protokolit dhe për këtë arsye të krijohen gazra dhe pluhura, poashtu edhe përdorimi jo adekuat i gypit fleksibil për mbushje shkakton lirimin e hidrokarburave aromatike.
4.4	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Kompania nuk posedon pajisje për trajtimin e gazrave shkaktues pasi që nuk shkarkon gazra në atë nivel dhe gazrat që lirohen gjatë procesit të punës janë të pa përfillshëm madje edhe të menagjueshëm nëse i kushtohet vetëm pak rëndësi procesit të furnizimit apo mbushjes me naftë dhe benzin.
4.5	Pajisjet për de-pluhurim	Kompania për të parandaluar ndikimet negative në ajër gjatë procesit teknologjik mund të përdorë ujin për pastrimin e platosë në rastë se gjatë mbushjes, kamionet kanë gomat e baltosura.
4.6	Monitorimi i emisioneve	N/A
4.7	Monitorimi i emisioneve/cilësis së ajrit	N/A
4.8.	Raportimet	N/A
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Masat që rekomandohen për shmangien e ndotjes së ajrit janë:

		➤ Lagia apo pastrimi në mënyrë të vazhdueshme i zonës ku bëhet qarkullimi i kamioneve për mbushje; ➤ Kufizimi i shpejtësisë së kamionëve ➤ Në raste kur hapësira apo pjesa e asfaltuar nuk është e pastruar duhet të bëhet lagia apo pastrimi i gomave të automjeteve të rënda apo kamioneve përpara se ato të dalin nga hapësirat e kompanisë ➤ Gjatë mbushjës së cisternave, mbushja të bëhet në mënyrë adekuate dhe të ketë kujdes të shtuar ➤ Mirëmbajtje e rregullt e makinerive të punës dhe kamioneve të kompanisë
5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Uji nuk futet apo nuk është pjesë e përdorimit gjatë këtij procesi
5.2 .	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Natyra e veprimtarisë nuk ka të bëjë me përdorimin të ujit prandaj nuk kemi shkarkime të ujërave
5.3.	Ndikimet në ujë	Natyra e aktivitetit nuk ka të bëjë me përdorimit të ujit prandaj nuk është e aplikueshme, mirepo ndotja mund të jetë eventualisht e pranishme nga rrjedhjet e padëshirueshme të naftës apo nga pakujdesia gjatë mbushjës së cisternave nga puntorë përgjegjës, gjithashtu ndotja mund të vijë edhe nga qarjet apo dëmtimet eventuale të rezervuarëve.
5.4	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Nuk ka emisione të ujërave të ndotura në këtë proces.
5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Në këtë veprimtari nuk ka emisione të ujërave të ndotur
5.6.	Kontrolli dhe matjet	N/A
5.7.	Raportimi	N/A

5.8.	Leje ujore për shfrytëzim të ujit	N/A
5.9.	Leje ujore për shkarkimin e ujërave	N/A
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Disa nga masat : ➤ Kur kamionet futen në hapsirat e biznesit të bëhet pastrimi i spërfaqeve në të cilat qarkullojnë, gjithashtu të bëhet edhe pastrimi i gomave të tyre para se të dalin nga hapësirat e biznesit ➤ Zhvillimi i protokolleve të qarta për stacionimin e kamioneve, duke siguruar që ato të jenë në një zonë të sigurt dhe të mirëmbajtur për të reduktuar rrezikun e rrjedhjeve nga mjetet e amortizuara. ➤ Sigurimi i trajnimeve të rregullta për punonjësit mbi procedurat e sigurta gjatë mbushjes së cisternave dhe menaxhimit të materialeve të rrezikshme, për të minimizuar rrezikun e rrjedhjeve dhe ndotjes.
6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Zhurma nga ky biznes mund të vij si rezultat i aktivitetit proceseve të punës nga mjetet e caktuara, kryesisht nga mjetet e transportit të cilat do të jenë të pranishme për të bërë mbushjen e cisternave, mirëpo për shkak të teknologjisë më të avancuar të këtyre mjeteve të cilat janë të mirëmbajtuara, atëhere niveli i zhurmës do të jetë nën kufijtë e lejuar me standarte.

6.2.	Kontrolli dhe matjet	Aktualisht nuk kryen kontroll dhe matje të zhurmes, kjo për arsye sepse ndikimi i zhurmes është i papërfillshëm
6.3.	Raportimet	N/A

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Ndotja e tokës, mund të ndodhë kur nafta ose përbërësit e saj kimik depërtojnë në substratin tokësor. Këto rrjedhje mund të vijnë nga rezervuarët nën tokë, ku mund të ndodhë qarja e shtresës së betoni që pastaj derivon deri tek qarje e ndonjë tubacione apo dëmtimi, gjithashtu ndotja mund të vijë edhe nga praktikrat e pamjaftueshme të mirmbajtjes.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Kompania, rezervuarët e saj nëntokësor i ka nën dhe (dheu), në shtresë të betonit nga të gjitha anët e tyre, gjë e cila e bën që ndikimi nga ky biznes në tokë të jetë thuajse i pa përfillshëm
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Kompania është siguruar që e gjithë hapësira punuese të jetë e rregulluar dhe të mos jetë dëmtuar, madje ka bërë edhe mbjelljen e barit dhe të pemëve në disa hapësira.

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimit sipas Katalogut Shtetëror të mbeturinave	Mbeturinat të cilat grumbullohen gjatë aktivitetit të kompanisë kryesisht janë mbeturinë si letra, plastika, mbeturinat komunale deponohen në kontejner dhe pastaj barten me kamionë nga kompanitë të cilat i dërgojnë në deponitë regjionale për trajtim të mbeturinave.
8.2	Përshkrimi i magazinimi apo deponimit të mbeturinave	Nuk bëhet magazinimi i përkohshëm i mbeturinave, por mbeturinat komunale që grumbullohen nga punonjësit ato vendosen në kontejnerë, ndërsa kompania “Ekoregjioni” i dërgon në deponitë regjionale.
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	N/A
8.4	Dërgimi për trajtim dhe riciklim te operatori tjetër-kontratë me kompaninë me leje përkatëse	N/A
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	N/A
8.6.	Raportimi	N/A

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

Kompania ka hartuar elaboratin e mbrojtjes nga zjarri andaj dhe brenda elaboratit janë të përshkruar edhe zonat e rrezikshme gjatë operimit:

Zonat e rrezikshme përcaktohen si vijon:

- **Zona 0** është zona në të cilën ka përzierje eksploduese gaz-ajër, vazhdimisht ose për periudha kohe të gjata;
- **Zona 1** është zona në të cilën ka mundësi të këtë përzierjes eksploduese gaz-ajër në kushtet e funksionimit normal;
- **Zona 2** është zona në të cilën nuk ka probabilitet të këtë përzierje eksploduese gaz- ajër në kushtet e funksionimit normal dhe po të këtë do të këtë vetëm për një periudhe të shkurtër kohe.

9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Kompania ka hartuar elaboratin e mbrojtjes kundër zjarrit ku edhe ka marrë pëlqimin nga AME (Agjencioni Menaxhimit të Emergjencave), ku brenda elaboratit shpjegohet edhe një planë për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut ku në rastet e zjarreve të vogla, lokale, në fillim të shfaqjes së tyre, zjarrin e fikë punëtori me aparatën doracak, ndërsa në rastin e zjarrit më të madh, duhen njësitë e specializuara për këtë nevojiten të thirren shërbimi profesional i zjarrëfikësave.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Kompania përdor vetëm hidrokarburet si naftë dhe benzinë andaj veprimtaria kryesore e këtij biznesi janë këto dy elemente të cilat nuk mund të i zëvendësoj.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimin e pasojave është nevojshme për të siguruar sistemin automatik për lajmërimin e zjarrit dhe sistemin stabil për shuarjen me pluhur, në mungesë të sistemit stabil për shuarjen e zjarrit rekomandohet që investitori të mbrohet me numër më të madh të aparatëve për mbrojtje nga zjarri ndërsa në raste kur aparatët e zjarrit nuk mund të japin suksese në shuarjen e zjarrit më të madhë, atëherë duhen njësitë e specializuara dhe të thirren shërbimi profesional i zjarrëfikësave.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	N/A

9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Kompania ka hartuar planin emergjent në kuadër të cilit përfshihet edhe plani për mbrojtjen ndaj zjarrit ku aty janë të përkthyer të gjitha aktivitetet dhe masat e nevojshme në rast të zjarrit janë të përfshira në këtë plan.
10. MASAT NË RASTET E PUNËS JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Aktualisht kompania nuk ka ndonjë arsye të ndërprerjes së punës por nëse ndodhë kjo, mund të ndodhë për arsye të rrjedhjes së derivateve apo qarjes së rastësishme të tanqeve apo rezervuareve, që nënkupton që ndërprerja do të vijë vetëm në raste të defekteve në procesin teknologjik dhe në raste të aksidenteve apo lëndimeve të puntorëve.
10.2.	Ndërprerja e punës	Deri më tani kompania nuk ka pasur ndërprerje të punës mirëpo në rast se arrihet në atë pikë për shkaqet e përmendura në paragrafin 10.1 atëherë kompania obligohet që të ndalojë procesin e punës dhe të rikthehet në punë me sajimin e problemit dhe rikthimin në funksion.
11. Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut		
Mund të konkludohet se projekti në fjalë nuk ka potencial të rrezikimit për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër, zhurmë dhe mbeturina, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara, këto ndikimet mund të minimizohen në nivel të kënaqshëm dhe të eliminohen thuajse në tërësi dhe të jenë të papërfillshme.		

Personi përgjegjës për mjedis

Emri Mbiemri Fisnik Muji

Nënshkrimi

Personi përgjegjës i kompanisë

Emri Mbiemri Fariz Mazrek

Nënshkrimi
